

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Qendra e Formimit Profesional Publik Shkodër

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

“PRODHIME ME MATERIALE TË RICIKLUESHME”

Për

*Personat me Aftësi të Kufizuar Intelektuale, niveli i parë dhe i dytë
&
Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike*

Kodi: PMR-PAK-23

Miratoi:

DREJTOR

.....

Shkodër, 2023

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“PRODHIME ME MATERIALE TË RICIKLUESHME”

(PMR-PAK-23)

I. Profili profesional i prodhuesit me materiale të riciklueshme

a) Karakteristikat e prodhuesit me materiale të riciklueshme

Prodhuesi me materiale të riciklueshme do të jetë i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar për të ofruar prodhime artizanale me artikuj prej druri, letre, kartoni, plastike, qelqi, tekstili, si dhe materiale të tjera të ngjashme me to.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, prodhuesi me materiale të riciklueshme duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehje** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të prodhuesit me materiale të riciklueshme.

Suksesi i prodhuesit me materiale të riciklueshme është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e prodhuesit me materiale të riciklueshme

Profesioni i prodhuesit me materiale të riciklueshme është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në lidhje me prodhimin e objekteve të nevojshme apo dekoruese (artizanale) me materiale të riciklueshme prej druri, letre ose kartoni, plastike, qelqi, si dhe tekstili, duke zbatuar teknikat dhe parimet e prodhimit të tyre, në varësi të llojit të materialit të riciklueshëm. Ai mund të punësohet ose vetëpunësohet në punishte artizanale që kanë të bëjnë me prodhime për artikuj druri, letre, kartoni, plastike, qelqi, apo tekstili, si dhe në ndërmarrje të përpunimit të drurit, tekstilit, letrës, kartonit, qelqit dhe plastikës. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë në shkollat profesionale apo trajnimet nëpërmjet punës, mund të përparojë profesionalisht në nivelin e ndihmës mjeshtrit ose mjeshtrit në artizanat, apo punëtorit të kualifikuar në ndërmarrjet e përpunimit të drurit, tekstilit, letrës, kartonit, qelqit dhe plastikës. Ndjekja e shkollës së lartë çon në diplomimin e specialistëve në këtë profesion. Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e artizanatit, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Punonjës të punimeve me dorë të drurit, tekstilit, lëkurës dhe materialeve të tjera të ngjashme”, me kod 733, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Prodhime me materiale të riciklueshme”

Në përfundim të Kursit për “Prodhime me materiale të riciklueshme”, kursantët do të jenë të aftë të:

- identifikojnë materialet e ndryshme të riciklueshme, sipas vetive të tyre;
- parapërgatitin vendin e punës për fillimin e punës;

- përzgjedhin dhe përdorin mjetet dhe materialet e punës për prodhimin e objekteve me materiale të riciklueshme, sipas llojit të tyre;
- përcaktojnë dimensionet dhe formën e objektit;
- kryejnë vizatime, skica të thjeshta dhe matje të ndryshme në materialet për t'u punuar;
- realizojnë prerjen sipas përmasave;
- kryejnë ngjitjen, lidhjen apo veprime të ngjashme me to, për bashkimin e elementeve, në varësi të llojit të materialit të riciklueshëm;
- përgatitin objekte dekorative prej druri, qelqi apo plastike;
- përgatitin objekte prej letre ose kartoni;
- kryejnë punime elementare të qepjes me dorë të copave të tekstilit;
- kryejnë hekurosjen;
- përgatitin çanta me copa tekstili;
- dizenojnë prodhimet me materiale të riciklueshme, sipas llojit të tyre;
- kombinojnë materialet e riciklueshme, sipas llojit dhe vetive të tyre;
- dekorojnë produktet me materiale të tjera të riciklueshme (gjethe, letër, gurëza, copa qelqi, rërë, lëkurë, etj.);
- bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve të realizuara;
- kryejnë modifikimet e ndryshme para përfundimit të objektit;
- riparojnë defektet e ndryshme;
- mirëmbajnë mjetet, materialet dhe paisjet në mjedisin e punës;
- përdorin tabelën e komunikimit (simbole, fjalë ose imazhe) për të ndërvepruar me të tjerët;
- përdorin aplikacione me specifika të veçanta për personat me vështirësi (dëgjimi, motorike, shikimi) për të ndërvepruar me të tjerët;
- rritin kreativitetin nëpërmjet krijimit të objekteve të ndryshme me materiale të riciklueshme;
- punojnë në mënyrë të pavarur ose në grup;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Prodhime me materiale të riciklueshme”

Pjesmarrësit në Kursin për “Prodhime me materiale të riciklueshme” duhet të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Prodhime me materiale të riciklueshme”

300 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Prodhime me materiale të riciklueshme”

Nr.	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme	PMR-PAK-01-23	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan profesionin e prodhuesit (artizanit) me materiale të riciklueshme. 2. Kursanti përshkruan materialet e riciklueshme (druri, letre, kartoni, plastike, qelqi, tekstili). 3. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, paisjet dhe proceset e punës që përdoren për prodhimin me materiale të riciklueshme. 4. Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes në mjedisin e punës.
2	Komunikimi i aksesueshëm	PMR-PAK-02-23	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan format e komunikimit të aksesueshëm. 2. Kursanti komunikon me të tjerët.
3	Përgatitja e prodhimeve me material prej druri	PMR-PAK-03-23	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit procesin e prodhimit me material prej druri. 2. Kursanti përgatit prodhime me material prej druri.
4	Përgatitja e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike	PMR-PAK-04-23	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit prodhime me material prej letre ose kartoni. 2. Kursanti përgatit prodhime me material prej plastike.

5	Përgatitja e prodhimeve me material prej qelqi	PMR-PAK-05-23	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit procesin e prodhimit me material prej qelqi. 2. Kursanti përgatit prodhime me material prej qelqi.
6	Përgatitja e çantave me copa tekstili të ndryshme	PMR-PAK-06-23	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit procesin e prodhimit të çantës me copa tekstili të ndryshme. 2. Kursanti pret copat e tekstilit për prodhimin e çantës. 3. Kursanti qep me dorë copat e tekstilit për prodhimin e çantës. 4. Kursanti përfundon çantën me copa tekstili të ndryshme.
7	Dekorimi i prodhimeve me materiale të riciklueshme	PMR-PAK-07-23	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme. 2. Kursanti parapërgatit procesin e dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme. 3. Kursanti kryen dekorimin e prodhimeve me materiale të riciklueshme.

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit (RN-të) që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse, që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Prodhime me materiale të riciklueshme”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E PRODHUESIT ME MATERIALE TË RIKIKLUESHME	PMR-PAK-01-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të prodhuesit me materiale të riciklueshme, mjetet, paisjet, proceset e punës që përdoren për prodhimin me materiale të riciklueshme, me rregullat e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes në mjedisin e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan profesionin e prodhuesit (artizanit) me materiale të riciklueshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e prodhimit me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë avantazhet e prodhimit me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë prirjet e zhvillimit të prodhimit (artizanatit) me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë funksionet dhe detyrat kryesore të prodhuesit (artizanit) me materiale të riciklueshme; - të identifikojë materiale të riciklueshme, si letër, karton, plastikë, dru, qelq, etj., për prodhimin e objekteve të ndryshme; - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të prodhuesit me materiale të riciklueshme; - të tregojë mundësitë e punësimit apo vetëpunësimit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë RN 2 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, paisjet dhe proceset e punës që përdoren për prodhimet me materiale të riciklueshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës gjatë prodhimit me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë mjetet dhe paisjet e punës që përdoren gjatë prodhimit me materiale të riciklueshme;	

- të përshkruajë organizimin e punës gjatë procesit të prodhimit me materiale të riciklueshme;
- të dallojë veglat, mjetet e punës, si dhe materialet ndihmëse për prodhimin e objekteve, sipas llojit të materialit të riciklueshëm;
- të përshkruajë lëndët, materialet ndihmëse (ngjitës, llak, fije peri, lëkurë etj.) për prodhimin e objekteve me materiale të riciklueshme;
- të përshkruajë proceset fillestare të punës për prodhimin me materiale të riciklueshme (mbledhja dhe seleksionimi i materialeve të riciklueshme);
- përshkruajë proceset e tjera të punës për prodhimin me materiale të riciklueshme (matja, shënimi, prerja, palosja, gërvishtja, ngjitja, montimi, lidhja, mbushja, etj.), në varësi të llojit të materialit të riciklueshëm;
- të identifikojë procesin e punës në varësi të materialit të riciklueshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

Pyetje përgjigje me gojë

RN 3 Kursanti përshkruan materialet e riciklueshme (druri, letre, kartoni, plastike, qelqi, tekstili).

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e materialeve të riciklueshme;
- të përshkruajë vetitë e drurit (kompensatës, fibrës, etj.);
- të përshkruajë vetitë e letrës dhe kartonit;
- të përshkruajë vetitë e plastikës;
- të përshkruajë vetitë e qelqit;
- të përshkruajë llojet dhe vetitë e tekstilit;
- të identifikojë dhe përzgjedhë materialet e riciklueshme sipas llojit të tyre (druri, letre apo kartoni, plastike, qelqi, tekstili);
- të tregojë prodhimet me materiale prej druri, letre, kartoni, plastike, qelqi dhe tekstili;
- të përshkruajë pamjen estetike të prodhimeve me materiale të riciklueshme;
- të përshkruajë përdorimet e objekteve të prodhuara me materiale të riciklueshme (druri, letre, kartoni, plastike, qelqi dhe tekstili).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë

RN 4 Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes në mjedisin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe rëndësinë e mbajtjes pastër dhe të rregullt të mjedisit të punës;

- të tregojë rëndësinë e kujdesit gjatë punës;
- të përshkruajë mundësitë e mënjanimi të rreziqeve fizike në punë;
- të përshkruajë dhënien e ndihmës së parë për dëmtimet e vogla;
- të përshkruajë rëndësinë e rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedis pune të përpunimit apo prodhimit me dorë me materialeve të riciklueshme.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata duhet të kryejnë detyra të ndryshme, që lidhen me njohjen e materialeve të riciklueshme, veglave dhe paisjeve që përdoren për prodhime me materiale të riciklueshme, rëndësinë e përdorimit të tyre, funksionin dhe detyrat e prodhuesit me materiale të riciklueshme.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Komploti i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e prodhimeve me materiale të riciklueshme, etj.
 - Ligji për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Komunikimi i aksesueshëm”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI I AKSESUESHËM	PMR-PAK-02-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përdorimin e formave të komunikimit të aksesueshëm, tabelës së komunikimit (simbole, fjalë ose imazhe), si dhe aplikacioneve të ndryshme në varësi të aftësisë së kufizuar, për të ndërvepruar me të tjerët.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan format e komunikimit të aksesueshëm. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e formave të komunikimit të aksesueshëm; - të përshkruajë kanalet e shpërndarjes së informacionit për një komunikim të aksesueshëm; - të identifikojë produkte, apo materiale të përshtatshme për të realizuar një komunikim të aksesueshëm; - të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të tabelës së komunikimit (simbole, fjalë ose imazhe që mund të përdoren për të shprehur mendimet e tyre); - të përshkruajë rëndësinë e komunikimit online; - të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të shfletuesve të internetit dhe aplikacioneve për personat me vështirësi (dëgjimi, motorike, shikimi); - të identifikojë aplikacionet, në varësi të aftësisë së kufizuar. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë	
	RN 2 Kursanti komunikon me të tjerët. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përdorë gjuhën e mbiemrave, për të përshkruar veprimet, objektet dhe situatat që ndodhin rreth një personi (për individët me vështirësi të pamjes); - të dallojë elementet e tabelës së komunikimit (simbole, fjalë ose imazhe); - të përdorë tabelën e komunikimit (simbole, fjalë ose imazhe) për të ndërvepruar me të tjerët;	

- të përdorë aplikacionet me specifika të veçanta për të ndërvepruar me të tjerët;
- të përdorë tekstualizimin nëpërmjet letërkëmbimit, mesazheve tekstuale, email-eve dhe materialeve të shkruara (për individët me vështirësi dëgjimi ose të foluri);
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise pune të përpunimit apo prodhimit me dorë me materialeve të riciklueshme.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata duhet të kryejnë detyra të ndryshme, që lidhen me format e komunikimit të aksesueshëm, përdorimin e tabelës së komunikimit dhe aplikacioneve me specifika të veçanta, për të ndërvepruar me të tjerët.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Komplet i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e komunikimit të aksesueshëm.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Përgatitja e prodhimeve me material prej druri”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E PRODHIMEVE ME MATERIAL PREJ DRURI	PMR-PAK-03-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përgatitjen e prodhimeve me material prej druri (vazo, mbajtëse çelësash, lule, kuti, apo të tjera të ngjashme me to), duke zbatuar teknikat dhe parimet e prodhimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	80 rë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti parapërgatit procesin e prodhimit me material prej druri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e prodhimit të objekteve me material prej druri; - të identifikojë dhe të përzgjedhë materialin (kompensatë, fibër, etj.) sipas objektit që do prodhojë (vazo, mbajtëse çelësash, lule, kuti apo të tjera të ngjashme me to); - të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhimin me material prej druri; - të përcaktojë objektin që do të prodhojë me material të riciklueshëm prej druri; - të përshtatë llojin e materialit prej druri me modelin e objektit; - të përshkruajë rradhën e proceseve të punës për prodhimin e objektit me material prej druri; - të listojë veprimet për prodhimin e objektit (pastrimin, tharjen, heqjen e ngërçeve, prerjen, gërvishtjen, harkimin, zumparimin, lustrimin, llakosjen etj.); - të përgatitë materialin prej druri për prodhimin e objekteve (vazo, mbajtëse çelësash, lule, kuti, etj.) - të pastrojë materialin për eliminimin e papastërtive; - të thajë materialin për eliminimin e lagështirës; - të përcaktojë formën e prodhimit me material prej druri; - të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhimin e objektit për dhënie formë (harkimin) sipas modelit; - të vendosë me kujdes materialet, veglat, paisjet në vendin përkatës të punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit:	

-
- Pyetje përgjigje me gojë
 - Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Kursanti përgatit prodhime me material prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë e/i aftë :

- të organizojë vendin e punës për prodhimin me material prej druri;
- të përcaktojë madhësinë prodhimit (objektit) me material prej druri;
- të bëjë skicime të thjeshta të objektit që do prodhojë me material prej druri;
- të kryejë matje sipas modelit;
- të shënojë materialin sipas skicës;
- të kontrollojë matjet sipas skicës;
- të gërvishtë materialin sipas shënimeve;
- të presë materialin sipas shënimeve;
- të kontrollojë prerjet, gërvishtjet apo veprime të tjera të ngjashme me to);
- të pastrojë me kujdes mbeturinat (ashklat);
- të vendosë elementet në drejtimin e duhur;
- të harkojë materialin sipas modelit të dëshiruar;
- të zumparojë me letër zumpare të imët sipërfaqen e materialit sipas shkallës të pastërtisë;
- të pastrojë me kujdes sipërfaqen e zumparuar;
- të bëjë vrima elementet sipas modelit;
- të mbërthejë, ngjitë ose lidh copat e materialit, sipas modelit të objektit të përzgjedhur;
- të montojë elementet e objektit sipas llojit të materialit të riciklueshëm;
- të fshijë lëndën ngjitesë të tepërt në sipërfaqen e materialit;
- të lustrojë sipërfaqen e materialit;
- të thajë në mënyrë natyrore pas lustrimit;
- të kontrollojë defektet e mundshme;
- të riparojë defektet, duke zumparuar apo lustruar;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve ndihmëse (ngjitësit, llakut dhe të tjera të ngjashme me to);
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedis pune të përpunimit apo prodhimit me dorë me material prej druri.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur,

	shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për matjen, shënimet, gërvishtjen, llakosjen, etj. të materialit prej druri, deri në realizimin përfundimtar të objektit prej druri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për realizimin e prodhimeve me material prej druri. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale pune në një punishte artizanale apo ndërmarrje përpunim druri. - Komplet i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e prodhimeve me material prej druri. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Përgatitja e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E PRODHIMEVE ME MATERIAL PREJ LETRE OSE KARTONI, SI DHE PLASTIKE	PMR-PAK-04-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përgatitjen e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike, në varësi të materialit, duke zbatuar teknikat dhe parimet e prodhimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përgatit prodhime me material prej letre ose kartoni. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e prodhimit të objekteve me material prej letre ose kartoni; - të organizojë vendin e punës për prodhimin me material prej letre ose kartoni (kartolina, urime, shënues, kuti, zarfe, etj); - të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhimin me material prej letre ose kartoni; - të përcaktojë objektin që do të prodhojë me material prej letre apo kartoni; - të identifikojë dhe përzgjedhë llojin e letrës apo kartonit sipas objektit që do prodhojë; - të përshtatë llojin e materialit prej letre apo kartoni me modelin e objektit; - të përshkruajë rradhën e proceseve të punës; - të listojë veprimet për prodhimin e objektit (shënimin, prerjen, palosjen, etj.); - të bëjë skicime të thjeshta të objektit që do prodhojë; - të kryejë matje sipas modelit; - të shënojë materialin sipas skicës; - të kontrollojë matjet sipas skicës; - të presë materialin sipas shënimeve me veglat prerëse; - të kontrollojë prerjet; - të palosë me dorë ose me vizore, në varësi të materialit (letër apo karton); - të ngjitë pjesët e letrës apo kartonit, sipas modelit të objektit të përzgjedhur; - të fshijë lëndën ngjitesë të tepërt në sipërfaqen e materialit; - të bëjë kontrollin përfundimtar;	

-
- të riparojë defektet;
 - të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve ndihmëse ngjitëse;
 - të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Kursanti përgatit prodhime me material prej plastike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e prodhimit të objekteve me material prej plastike;
- të organizojë vendin e punës për prodhimin me material prej plastike (vazo, kuti, mbajtëse lapsash, kufje etj);
- të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhimin me material prej plastike;
- të përcaktojë objektin që do të prodhojë më material prej plastike;
- të identifikojë dhe përzgjedhë llojin e plastikës sipas objektit që do prodhojë;
- të përshtatë llojin e materialit me modelin e objektit;
- të përshkruajë rradhën e proceseve të punës;
- të listojë veprimet për prodhimin e objektit (shënimin, prerjen, përpunimin, etj.);
- të presë dhe të formojë plastikën sipas modelit të dëshiruar;
- të kontrollojë prerjet;
- të bëjë vrima, për të lidhur pjesët e plastikës edhe me lidhëse;
- të ngjitë pjesët e plastikës, sipas modelit të objektit të përzgjedhur;
- të fshijë lëndën ngjitëse të tepërt në sipërfaqen e materialit;
- të bëjë kontrollin përfundimtar të prodhimit me material prej plastike;
- të riparojë defektet;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve ndihmëse ngjitëse;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedise pune të përpunimit apo prodhimit me dorë me materiale prej letre, kartoni dhe plastike.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur,

	shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për palosjen, prerjen, ngjitjen, etj., të materialeve prej letre ose kartoni, si dhe plastike, deri në realizimin përfundimtar të prodhimit të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për realizimin e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale pune në një punishte artizanale apo ndërmarrje përpunimi të letrës ose kartonit, si dhe plastikës. - Komploti i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Përgatitja e prodhimeve me material prej qelqi”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E PRODHIMEVE ME MATERIAL PREJ QELQI	PMR-PAK-05-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përgatitjen e prodhimeve me material prej qelqi, duke zbatuar teknikat dhe parimet e prodhimit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”.	
Rezultatet e të nxëniet (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti parapërgatit procesin e prodhimit me material prej qelqi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë e/i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e prodhimit të objekteve me material prej qelqi; - të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhime me material prej qelqi; - përcaktojë objektin që do të prodhojë me material prej qelqi; - të përcaktojë modelin e objektit me material prej qelqi; - të përshkruajë rradhën e proceseve të punës për prodhimin e objektit; - të listojë veprimet për prodhimin e objektit (ngrohja, formimi, ftohja etj.); - të përzgjedhë objektin prej qelqi (kavanoz, shishe, filxhan, etj.) në varësi të objektit që do prodhojë (vazo, mbajtëse lapsash, lule, instalacion, kuti apo objekte të tjera të ngjashme me to); - të përshkruajë mënyrën e manipulimit të qelqit; - të përgatitë materialin prej qelqi për prodhimin e objekteve sipas dëshirës (vazo, mbajtëse lapsash, instalacione, lule, kuti apo të tjera të ngjashme me to); - të përcaktojë formën e prodhimit me material prej qelqi; - të vendosë me kujdes materialin, veglat, paisjet në vendin përkatës të punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli	
	RN 2 Kursanti përgatit prodhime me material prej	

qelqi.

Kriteret e vlerësimit:

- të organizojë vendin e punës për prodhimin me material prej qelqi;
- të pastrojë qelqin, nëpërmjet ngrohjes;
- të thajë qelqin për eliminimin e lagështirës;
- të përcaktojë madhësinë prodhimit (objektit) me material prej qelqi;
- të ngrohë qelqin, derisa të bëhet i shkëlqyeshëm dhe i lëmuar në një gjendje të deformueshme;
- të formojë qelqin pas ngrohjes;
- të përdorë veglat për kryerjen e formimit apo deformimit të qelqit (thonjza, shufër, etj.);
të kryejë shtypjen, vërtitjen, tërheqjen ose mbledhjen e qelqit në forma të ndryshme për të krijuar objekte;
- të kontrollojë shtypjen, vërtitjen, tërheqjen ose mbledhjen e qelqit në forma të ndryshme;
- të ftohë gradualisht qelqin;
- të realizojë gëlqerimin, gravimin sipas objektit të dëshiruar;
- të llakosë qelqin për rritjen e shkëlqimit;
- të bëjë kontrollin përfundimtar të prodhimit me material prej qelqi;
- të riparojë defektet;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedis pune të përpunimit apo prodhimit me dorë me material prej qelqi.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ngrohjen, ftohjen, shtyrjen, tërheqjen, llakosjen, etj. të materialit prej qelqi, deri në realizimin përfundimtar të prodhimit me material prej qelqi, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për realizimin e prodhimeve me material prej qelqi.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

	kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, paisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale pune në një punishte artizanale apo ndërmarrje përpunimi të qelqit. - Komploti i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e prodhimeve me material prej qelqi. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Përgatitja e çantave me copa tekstili të ndryshme

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E ÇANTAVE ME COPA TEKSTILI TË NDRYSHME	PMR-PAK-06-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përgatitjen e çantës me copa tekstili, duke kryer veprimet praktike që lidhen me matjen, skicimin, prerjen, qepjen dhe hekurosjen e copave të tekstilit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti parapërgatit prodhimin e çantës me copa tekstili të ndryshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e prodhimit të çantave me copa tekstili të ndryshme; - të përzgjedhë veglat dhe paisjet për prodhimin e çantës me copa tekstili; - të përshkruajë rradhën e proceseve të punës; - të listojë veprimet për prodhimin e çantës (matjen, shënimin, prerjen, qepjen me dorë, etj.); - të përshkruajë kombinimet e copave të tekstilit sipas llojit të pëlhurës dhe ngjyrës; - të përgatitë copat e tekstilit për prodhimin e çantës; - të pastrojë copat e tekstilit për eliminimin e papastërtive; - të përcaktojë modelin e çantës; - të identifikojë dhe të përzgjedhë copat e tekstilit që do përdorë për prodhimin e çantës; - të përcaktojë llojet e pejrave që do përdoren për qepjen e copave të tekstilit; - të vendosë me kujdes copat e tekstilit, veglat, paisjet në vendin përkatës të punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RN 2 Kursanti pret copat e tekstilit për prodhimin e çantës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të organizojë vendin e punës për prerjen e copave të tekstilit;	

- të përzgjedhë mjetet dhe paisjet e duhura për prerjen e copave të tekstilit;
- të përgatitë copat e tekstilit për prerje, duke zgjedhur drejtimin e duhur;
- të skicojë copat e tekstilit për prerje me forma gjeometrike sipas dëshirës;
- të përcaktojë madhësinë e copave të tekstilit për prodhimin e çantës;
- kryejë matjet e copave të tekstilit sipas skicës;
- të bëjë shënime mbi copë;
- të kontrollojë matjet sipas skicës;
- të presë copat e tekstilit sipas shënimeve;
- të kontrollojë prerjet e copave të tekstilit;
- të pastrojë me kujdes copat nga fijet anësore të pëlhurës;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti qep me dorë copat e tekstilit për prodhimin e çantës.

Kriteret e vlerësimit:

- të organizojë vendin e punës për qepjen e copave të tekstilit;
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe paisjet e duhura për qepjen e copave të tekstilit;
- të përshtatë llojin e materialit të copave të tekstilit me modelin e çantës;
- të kombinojë copat e tekstilit sipas llojit të pëlhurës dhe ngjyrës;
- të hekurosë copat e tekstilit;
- të vendosë copat e tekstilit në drejtimin e duhur, sipas skicës;
- të përshtatë perin me copën e tekstilit sipas trashësisë apo llojit të saj;
- të qepë copat e tekstilit me rradhë, sipas skicës;
- të bëjë kontrollin përfundimtar pas qepjes së çantës;
- të riparojë defektet;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti përfundon çantën me copa tekstili të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për qepjen përfundimtare të çantës;
- të përzgjedhë materialet, mjetet dhe paisjet e duhura për qepjen përfundimtare të çantës;
- të përcaktojë materialin për përgatitjen e rripit (copa tekstili apo lëkure);
- të përcaktojë gjatësinë e rripit të çantës;
- të përgatitë rripin e çantës (matë, shënojë, presë, qepë, hekurosë apo veprime të tjera të ngjashme me to, sipas llojit të materialit);
- të qepë ose lidh rripin me çantën;
- të vendosë (qepë ose ngjitë) mbërthesa;
- të përgatitë astar sipas dëshirës (matë, shënojë, presë, qepë, hekurosë);
- të bashkojë astarin me çantën;
- të kontrollojë saktësinë e proceseve të qepjes së çantës;
- të riparojë defektet;
- të kryejë punimet e nevojshme përfundimtare;
- të kryejë hekurosjen përfundimtare të çantës;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedis pune të përpunimit apo prodhimit me dorë të çantave prej tekstili.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata duhet të kryejnë detyra të ndryshme, që lidhen me kombinimin e copave të tekstilit të ndryshme, matjen, shënimin, prerjen dhe qepjen e tyre, deri në realizimin përfundimtar të çantës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për realizimin e çantës me copa tekstili të llojeve të ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale pune në një punishte artizanale apo ndërmarrje tekstili. - Komplet i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e çantave me copa tekstili të ndryshme. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	--

7. Moduli “Dekorimi i prodhimeve me materiale të riciklueshme”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DEKORIMI I PRODHIMEVE ME MATERIALE TË RICIKLUESHME	PMR-PAK-07-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për përgatitjen e dekorimit të objekteve të prodhuara me materiale të riciklueshme, duke kombinuar objektin me materialin dekorues, sipas llojit të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet: “Hyrje në profesionin e prodhuesit me materiale të riciklueshme”, “Përgatitja e prodhimeve me material prej druri”, “Përgatitja e prodhimeve me material prej letre ose kartoni, si dhe plastike”, “Përgatitja e prodhimeve me material prej qelqi” dhe “Përgatitja e çantave me copa tekstili të ndryshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan procesin e dekorimit të objekteve të prodhuara me materiale të riciklueshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë veglat dhe paisjet që përdoren për dekorimin e të prodhimeve me materiale të riciklueshme; - të përshkruajë llojet dhe vetitë e materialeve të riciklueshme që përdoren për dekorim (gjethe, spango, litar, lëkurë, guaska, rërë, lëkurë, etj.); - të përshkruajë kombinime të ndryshme të materialeve të tjera të riciklueshme dekoruese; - të dallojë proceset e punës nga njëri – tjetri; - të përshkruajë rradhën e proceseve të punës për dekorimin e objektit, sipas llojit të materialit që do të përdoret; - të listojë veprimet për dekorimin e objektit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë RN 2 Kursanti parapërgatit procesin e dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të organizojë vendin e punës për realizmin e dekorimit prodhimeve me materiale të riciklueshme; - të përzgjedhë veglat dhe materialet për realizimin e dekorimit të objektit, sipas llojit të tij; - të përshtatë modelin e dekorimit dhe materialet dekoruese, me objektin që do dekorojë;	

- të përcaktojë objektin që do të dekorojë;
- të përcaktojë modelin e dekorimit;
- të përzgjedhë materialet e riciklueshme dekoruese (gjethe, spango, litar, lëkurë, guaska, rërë, lëkurë, etj.);
- të bëjë pastrimin e materialeve të riciklueshme dekoruese (larjen, fshirjen, tharjen);
- të përzgjedhë lëndët ngjitëse dhe të tjera të ngjashme me to, që shërbejnë për dekorimin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Kursanti kryen dekorimin e prodhimeve me materiale të riciklueshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë skicime të thjeshta për dekorime, sipas objekteve të prodhuara;
- të presë, grimcojë apo veprime të tjera të ngjashme me to, në varësi të objektit dhe materialit për dekorim;
- të realizojë dekorimin me ndërthurje të materialeve, në përshtatje me objektin;
- të përcaktojë modelin e dekorimit që do realizojë;
- të kombinojë materialet e riciklueshme (gjethe, spango, litar, lëkurë, guaska, rërë, lëkurë, etj.) për dekorim;
- të krijojë aplikacione me materiale të ndryshme të riciklueshme;
- të kombinojë aplikacionet me objektin, në varësi të modelit të skicuar;
- të ngjitë materialet dekoruese;
- të lyejë me bojë prodhimet prej plastike, qelqi apo druri;
- të ngjyrosë prodhimet me materiale prej letre ose kartoni;
- të qepë aksesorë zbukurues në çantën me copa prej tekstili;
- të ngjitë materialet e tjera ricikluese në objektet e prodhuara;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve ngjitëse dhe të tjerave të ngjashme me to, që shërbejnë për dekorimin;
- të mirëmbajë veglat dhe paisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjedis pune të dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur,

	shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrimet konkrete të shprehive praktike që përmban moduli. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për prerjen, ngjitjen, grimcimin etj. e materialeve dekoruese, deri në realizimin përfundimtar të dekorimit, duke i kombinuar sipas llojeve të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për realizimin e procesit të dekorimit të prodhimeve me materiale të riciklueshme. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale pune në një punishte artizanale. - Komplet i materialeve, mjeteve dhe paisjeve për realizimin e dekorimit të objekteve me kombinime të materialeve të tjera të riciklueshme, si: gjethe, spango, lëkurë, guacka, rërë, etj. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.